VENDIM
Nr.213, datë 18.4.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.230, DATË 4.4.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PRIVATIZIMIN E PJESËVE TË KAPITALIT TË ZOTËRUAR NGA SHTETI, NË SHOQËRITË ME KAPITAL TË PËRBASHKËT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.230, datë 4.4.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i dytë i pikës 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Ortaku shtetëror njofton ministrinë apo institucionin, qendror a vendor, nga i cili ka pasur varësinë ndërmarrja shtetërore në çastin e nënshkrimit të kontratës, për krijimin e shoqërisë me kapital të përbashkët, si dhe shoqërinë, për miratimin e privatizimit të pjesës shtetërore të kapitalit.".

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Ortaku shtetëror thërret asamblenë e ortakëve për marrjen, nga ortaku joshtetëror, të miratimit të privatizimit të kuotave, të zotëruara nga shteti, si dhe propozon e zgjedh ekspertët përkatës, të cilët miratohen në asamble për vlerësimin e shoqërisë, për efekt të shitjes së pjesës shtetërore.".

3. Paragrafi i dytë i pikës 4 shfuqizohet.

4. Paragrafi i dytë i pikës 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Dokumentacioni i privatizimit, i përgatitur nga shoqëria, përcillet në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila ia dërgon, më pas, Ministrisë së Financave.".

5. Pika 19 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"19. Nga të ardhurat e shitjes së pjesëve të kapitalit të zotëruar nga shteti përfitojnë:

a) Ministria e Financave, 5 për qind;

b) Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, 5 për qind;

c) Buxheti i Shtetit, 90 për qind.

Kriteret e administrimit dhe të përdorimit të fondit, që përfiton Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha